

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL**, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve: B., F. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par. 1 pika 4 të KPK-së, dhe Sh.,B., dhe A. F., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas propozim akuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.5100/2012 dt.12.11.2012, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 31.07.2015, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina – Enver Krasniqi, të dëmtuarit, mbrojtësit av.M. S. si dhe të akuzuarve, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 07.08.2015 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari Sh. F.**, i biri i H. dhe Xh. e gjinisë E., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B. Komuna e P., ku dhe tani jeton, me nr. personal: *numër personal...*, i martuar baba i gjashtë (6) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në ujësjellësin R.-B., i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

**I akuzuari B. F.**, i biri i H. dhe Xh. e gjinisë E., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B. Komuna e P., ku dhe tani jeton, me nr. personal: *numër personal...*, i martuar baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

**I akuzuari B. F.**, i biri i H. dhe Xh. e gjinisë E., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B. Komuna e P., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...”, me nr. personal: *numër personal...*, i martuar baba i një (1) fëmiju, ka të kryer shkollën e mesme, profesioni teknik i ndërtimtarisë, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

**I akuzuari A. F.**, i biri i H. dhe Xh. e gjinisë E., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B. Komuna e P., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...”, me nr. personal *numër personal...*, i martuar baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, profesioni ndërtimtar, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANË FAJTORË

### **I akuzuari Sh. F.,**

**I.** Me date 11.08.2012, rreth orës 18:00, në fshatin B., në P. para lokalit me mbi shkrimin “Ç.”, për shkak se i pandehuri ishte revoltuar me të dëmtuarin M. M., i cili kishte pas një lidhje dashurie me vajzën e tij L. F. dhe me te tani ishte ndarë, me dashje që t`i shkaktojë lëndime trupore, posa e kishte vërejtur të dëmtuarin M. M., me mjet të përshtatshëm për shkaktim të lëndimit të rëndë trupor, shkop të drurit-Stupc e ka goditur në trup dhe në kokë të dëmtuarin, me ç`rast nga goditjet e marra i njëjti kishte pësuar lëndime të lehta trupore, të shoqëruara me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, me këtë rast lëndime të lehta trupore kishte pësuar edhe i pandehuri Sh. F.,

-Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 lidhur me par. 1 pika 4 lidhur të KPK-së.

### **Të akuzuarit B.F., B. F. dhe A.F.,**

**II.** Me datë si në dispozitivin e parë të kësaj propozim akuze rreth orës 22:30, në fshatin B., Komuna e P., për motive të përmendura si më lartë, derisa i dëmtuari ishte duke qëndruar para shtëpisë së tij kanë ardhë të pandehurit B., B1. dhe A. F. dhe me dashje që t`i shkaktojnë lëndime trupore, të pandehurit B. dhe B1. me mjet të përshtatshëm për shkaktim të lëndimit të rëndë trupor stupc të drurit e kanë goditur në pjesën të ndryshme të trupit dhe në kokë të dëmtuarin, ndërsa i pandehuri A. e ka goditur me grusht në pjesë të ndryshme të trupit, me ç`rast edhe i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

-Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 lidhur me par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

Andaj, gjykata në bazë të neneve 3,15,23,34,35,36,64 dhe 67 par.6 të KPK-së, nenit 46 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365,450,453,463 të KPPRK-së, i

## G J Y K O N

**1. Sh.F.,** me dënim me gjobë, ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej **500€(pesëqind/euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj në këste mujore në afat prej 6 (gjashtë) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**2. B.F.,** me dënim me gjobë, ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej **500€ (pesëqind/euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj në këste mujore në afat prej 6 (gjashtë) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**3. B.F.**, me dënim me gjobë, ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej **500€ (pesëqind/euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj në këste mujore në afat prej 6 (gjashtë) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**4. A.F.**, me dënim me gjobë, ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej **500€(pesëqind/euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj në këste mujore në afat prej 6 (gjashtë) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë në këste mujore në afat prej 6 (gjashtë) muajsh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ua zëvendësoj me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t'u llogaritet 1 (një) ditë burg.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë solidarisht, shumën prej **51.1€** (për dy ekspertiza mjeko-ligjore), si dhe në emër të shpenzimeve paushalle, secili veç e veç të paguajnë shumën prej **30€** (tridhjetë/euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari M. M. nga fshati B., KK. P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur propozim akuzën, PP.nr.5100/2012 dt.12.11.2012, kundër të akuzuarve: B. F. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK-së, dhe Sh., B. dhe A. F., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor më dt.31.07.2015, gjatë së cilës u dëgjuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të akuzuarit dhe mbrojtësi av. M. S..

Pas leximit të propozim akuzës, Prokurori i shtetit ka deklaruar se e bën rikualifikimin e veprës penale të dispozitivit nën dy të propozim akuzës sa i përket të akuzuarit A. F. ashtu që kualifikimi duhet të jetë B., B1. dhe A. F. në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Të akuzuarit e lartcekur në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas konsultimeve të mjaftueshme në tërësi e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e propozim akuzës dhe e kanë ndie veten fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata vërtetoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban propozim akuza në materialet e prezantuara nga prokurori shtetit, dhe propozim akuza nuk përmban shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit Enver Krasniqi, dhe të dëmtuarit, si dhe mbrojtësit të akuzuarit Sh. F. av.M. S., si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 326 par.4 të KPP-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me fjalën përfundimtare.

Prokurori i shtetit Enver Krasniqi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tersi pranë propozim akuzës dhe ka kërkuar që të njëjtit ti shpall fajtorë dhe t'i dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se parashtroi kërkesë pasurore juridike, por ka shtuar se nuk mundem saktësisht të precizoj lartësinë e kompensimit, ndërsa sa i përket të akuzuarve i' a lë gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. F. av.M. S. në fjalën e vetë përfundimtare deklaroi: Meqenëse i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë vullnetarisht dhe është penduar për rastin që ka ndodhur, dhe i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, i propozoj gjykatës që të ketë rrethana lehtësuese pasi që është mbajtës i vetëm i familjes.

Të akuzuarit: Sh.i, B., B1. dhe A. F., në fjalën e tyre përfundimtare deklaruan se e ndjejnë vetën të fajshëm, kanë shtuar se pendohen, ndjejnë keqardhje duke i kërkuar falje të dëmtuarit dhe u zotuan para gjykatës se nuk do ta përsëritin asnjëherë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërtetoi se me veprimet inkriminuese të akuzuarve të lartcekur përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penalo-juridik janë përgjegjës, andaj ju shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale me dashje, me paramendim, sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e tyre dhe e kanë dashur kryerjen e veprës penale.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjeti faktin pranimin e fajësisë, ishin korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ka të dhëna se kanë qenë të gjykuar më parë, e duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, intensitetin e

rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata duke aplikuar Kufijtë e Zbutjes së Dënimeve në bazë të nenit 67 par 6 të KPK-së, të akuzuarit i shpalli fajtorë dhe i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që në vend të dënimit me burgim ju shqiptoj dënim me gjobë si dënim kryesor, dhe konsideroi se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale si dhe përgjegjësisë penale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre dhe si masë parandaluese me efekt në persona të tjerë për moskryerjen e veprave penale e të parapara sipas dispozitës së nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim u marrë në kuptim të nenit 46 të Kodit penal të Republikës së Kosovës, i cili është më i favorshëm për të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se nuk ka pasur prova për të vendosur pasi që i dëmtuari nuk e ka precizuar dëmin e shkaktuar.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL**  
**P.nr.1412/12,dt.07.08.2015**

**Sekretare Juridike**  
Mihrie Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të  
Ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh  
nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së  
Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.